



Prishtinë, 28 prill 2011
Kodi i ZRRE-së: V_365_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4 dhe 12 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 57.8 MW që përbëhet prej pesë (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Kuqishta” me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, “Drelaj I” me kapacitet të instaluar prej 4.3 MW, “Drelaj II” me kapacitet të instaluar prej 5.4 MW, “Shtupeq” me kapacitet të instaluar prej 11.6 MW dhe “Rugova” me kapacitet të instaluar prej 31.8 MW, të gjitha në komunën e Pejës, të datës 03.02.2011 të ndërmarrjes Kelkos - Energy sh.p.k., me adresë “Arbëria” Dragodani – Zagrebit 19/22 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 prill 2011 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Kelkos – Energy” sh.p.k. ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) nga uji, me kapacitet të tërësishëm të instaluar prej 57.8 MW, që përbëhet prej pesë (5) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Kuqishta” me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, “Drelaj I” me kapacitet të instaluar prej 4.3 MW, “Drelaj II” me kapacitet të instaluar prej 5.4 MW, “Shtupeq” me kapacitet të instaluar prej 11.6 MW dhe “Rugova” me kapacitet të instaluar prej 31.8 MW, të gjitha në komunën e Pejës.
- II. Aplikantit Kelkos –Energy sh.p.k. mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 12 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues.
- III. Ky Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk nënkupton edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.



Arsyetim

- ZRRE me datë 03.02.2011 nga ndërmarrja **Kelkos – Energy sh.p.k.**, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 57.8 MW, që përbëhet prej pesë njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Kuqishta” me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, “Drelaj I” me kapacitet të instaluar prej 4.3 MW, “Drelaj II” me kapacitet të instaluar prej 5.4 MW, “Shtupeq” me kapacitet të instaluar prej 11.6 MW dhe “Rugova” me kapacitet të instaluar prej 31.8 MW, të gjitha në komunën e Pejës.
- ZRRE pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të tij.

IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar